



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
LUSHNJË

Nr. 9135 Prot

Lushnjë, më 03.12.2024

Lënda: Njoftim mbi verifikimin e kandidaturave në fazën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë "Specialist IT dhe Statistike"

Drejtuar: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR , TIRANË.
Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Tiranë.

Bazuar në nenin 80, të ligjit nr. 98/2016 "Per organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 71, dt 20.05.2019 "Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës , si dhe Vendimit Nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Mbi lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, me anë të cilit janë përcaktuar rregulla të hollësishme për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, shpalljen e një pozicioni të lirë "Specialist IT dhe Statistike", pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë,

Ju njoftoj:

Në përfundim të verifikimit paraprak, për përmbushjen e kriterëve, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin "Specialist IT dhe Statistike" u paraqit një kandidaturë:

1. Z. Alban Kënaci (Nr.8960 Prot, datë 21.11.2024).

Kandidati kualifikohet për të kaluar në fazën e intervistimit nga Këshilli i Gjykatës.

Kandidati do të njoftohet për datën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

KANCELARE

ALMA JANO

